

VENDIM
Nr. 14, datë 19.1.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “KOMP ENERGJI” SHPK, ME NUMËR 248, SERIA PV14K, MIRATUAR
ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR.94, DATË 6.10.2014, PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et “HURDHAS 1”, “HURDHAS
2”
DHE “HURDHAS 3”**

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “b” dhe 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr. 840, datë 11.6.2008 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; neneve 10 dhe 15 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, të Bordit të ERE-s; nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, të Bordit të ERE-s; nenit 8, të kontratës koncesionare nr. 2807 rep., dhe nr. 371 kol., datë 1.9.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me modifikimin e licencës së aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Komp Energji” sh.p.k. është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, me fuqi 1,71 MW, “Hurdhas 2”, me fuqi 1,3 MW dhe “Hurdhas 3”, me fuqi 1,2 MW, për një afat 30-vjeçar, me licencën nr. 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 94, datë 6.10.2014.

- Me shkresën nr. 791 prot., datë 11.11.2016, koncensionari “Komp Energji” sh.p.k., ka kërkuar zëvendësimin e emrit të koncensionarit “Komp Energji” sh.p.k., që mban tashmë licencën e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2”, “Hurdhas 3”, me nr. 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 94, datë 6.10.2014, me emrin e shoqërisë koncesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k.

- Referuar kërkesës nr. 791 prot., datë 11.11.2016, të koncensionarit, si dhe aplikimit të po kësaj shoqërie për licencim, kërkesa të cilat nuk vijnë në pajtim me njëra-tjetrën dhe frymën e ligjit për koncensionet, tregojnë se veprimet e shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k., në cilësinë e Koncensionarit, për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, janë veprime jokorrekte, të cilat kanë sjellë paqartësi gjatë procedurës së licencimit, për rrjedhojë, del e nevojshme të bëhet modifikimi i licencës në favor të shoqërisë koncesionare “Hidropower-plant Construction” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës me numër 248, seria PV14K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 94, datë 6.10.2014, për prodhimin të energjisë elektrike nga HEC-et “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”, të mbajtur nga koncensionari “Komp Energji” sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike

nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti